



# DITARI I NATYRËS

*Nr.89 - Tetor 2020 / viti i tetë i publikimit*



## Burimet natyrore nën presion

Burimet natyrore në Shqipëri janë duke vuajtur nga presionet, janë nën kërcënime të vazhdueshme, duke përfshirë prerjet e paligjshme të pyjeve dhe të mbulesës vegetative, gjuetinë, turizmin e pakontrolluar dhe aktivitetet rekreative jo mirë të menaxhuara, erozionin dhe degradimin e tokës, zjarret, keq menaxhimin dhe përdorimin jo të qëndrueshëm të ujërave, hapjen e gurove dhe të minierave, ndërtimin e HEC-ve si dhe tjetërsimin e peizazhit natyror....

[Për më tepër...](#)



## Natyra në sytë e fëmijëve

Ndonëse në kushte të vështira të pandemisë, nxënësit vazhdojnë t'i kushtojnë vëmendje natyrës përreth tyre, duke e theksuar rëndësinë e saj në veçanti në kushtet kur ruajtja e natyrës është një ndër problematikat mbarë botërore.

[Për më tepër...](#)

## Të njohim llojet e rëndësishme të florës dhe faunës

Njerëzit në zonat e mbrojtura janë të lidhur me burimet natyrore dhe ekosistemet që mbështesin të ardhmen e tyre social-ekonomike dhe njohja e këtyre burimeve natyrore dhe vlerave të tyre, është e rëndësishme për të krijuar përdorim të qëndrueshëm të këtyre burimeve...

[Për më tepër...](#)



## Nga Mali në Det

Parku Kombëtar i Llogarasë është një zonë e cila mund të vlerësohet si zona më e pasur me specie endemike për të cilat në krenohemi...

[Për më tepër...](#)

## Peshkimi i qëndrueshëm kërkon njohuri të reja

Vazhdojnë takimet në kuadër të projektit "Menaxhimi i peshkimit të qëndrueshëm artizanal dhe atij rekreativ në ZMD Karaburun-Sazan"...

[Për më tepër...](#)



## Qendra multifunktionale - mundësi për promovimin e zonave të mbrojtura

Inagurohet Qendra multifunktionale pranë ambjenteve të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Berat.

[Për më tepër...](#)

## Peshkaqenët rrezikohen nga njeriu

Tërheqje vëmendjeje për informacionet mbi prezencën dhe kapjen e peshkaqenëve në detet Adriatik dhe Jon!



[Për më tepër...](#)



## Kriza e natyrës shpjeguar në pesë grafike

Aktivitetet njerëzore po shkatërrojnë botën natyrore, duke çuar në zhdukjen e specieve shtazore dhe bimore me një shpejtësi alarmante...

[Për më tepër...](#)

## Breshkat e detit folenizojnë në Shqipëri

Zyrtarë dhe ekspertë takohen për të diskutuar mbi rezultatet e projektit studimor në lidhje me folezimin e breshkave detare në Shqipëri...

[Për më tepër...](#)



Parlamenti Evropian votoi për 60% ulje të shkarkimeve të CO2 brenda vitit 2030

[Për më tepër...](#)

## Data të rëndësishme



**OCTOBER 4**

[www.worldanimalday.org.uk](http://www.worldanimalday.org.uk)

### 4 Tetor - Dita

#### Botërore e Kafshëve

Dita Botërore e Kafshëve i ka fillesat e saj në vitin 1931, në Konventën e Ekologjistëve të mbajtur në Firenze, Itali, si një mënyrë për të hedhur dritë mbi vështirësitë e llojeve të rrezikuara. Më pas, kjo ditë u shndërrua në një ditë festive për të gjithë ata që duan kafshët, në të gjitha llojet e tyre...

[Për më tepër...](#)

### 5 Tetor - Dita

#### Botërore e Habitatit

Kombet e Bashkuara kanë përzgjedhur të



Housing For All:  
A Better Urban Future

hënë e parë të Tetorit si Ditën Botërore të Habitatave në përkujtim të përvjetorit të konferencës së parë Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara mbi kolonizimet njerëzore, mbajtur në Vankuver, Kanada në 1976...

[Për më tepër...](#)



**DITA e MBROJTJES së  
DINARIDEVE**  
7 TETOR 2020



**7 Tetor - Dita e  
Mbrojtjes së  
Dinarideve**



Dita e Mbrojtjes së Dinarideve - 7 Tetor, u krijua më 29 maj 2019 në Asamblenë e Përgjithshme të Parqeve Dinaride - një rrjet i zonave të mbrojtura të Dinarideve, në Parkun Natyror Blidinje (Bosnjë dhe Hercegovinë)...

[Për më tepër...](#)



**7 Tetor - 3 vjet  
Qendra e Vizitorëve**

...fragmente nga ceremonia e inagurimit të Qendrës së Vizitoreve në Parkun Kombëtar Detar Karaburun - Sazan...

[Për më tepër...](#)



## Dita Botërore e Shpendëve Migratorë

Dita Botërore e Shpendëve Migratorë ka filluar të festohet nga viti 2006 dhe ka si qëllim që të sjellë në vëmendjen e popullatës dhe të shërbejë si një ditë ndërgjegjësimi për mbrojtjen e shpendëve migrator dhe habitatet e tyre...

[Për më tepër...](#)

---

### Pak Histori...

#### ...8 vjet më parë...

...miratohet [Ligji nr.111/2012, dt.15.11.2012](#) "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", [Fletore Zyrtare Nr.157, dt.6 Dhjetor 2012](#)...

[Akte që kanë ndryshuar aktin e më sipërm...](#)

---

#### ...10 vjet më parë...

...miratohet [VKM Nr.995, dt.03.11.2010](#), Për shpalljen "Rezervat natyror i menaxhuar" të ekosistemit natyror ligatinor të Patok - Fushëkuqe - Ishëm", [Fletore Zyrtare Nr.176, dt.30 Dhjetor 2010](#)...

---

#### ...15 vjet më parë...

...miratohet [VKM Nr.693, dt.10.11.2005](#), "Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit "Park Kombëtar". [Flet.Zyrtare Nr.91, dt.1 Dhjetor 2005](#).

[Akte që kanë ndryshuar aktin e më sipërm...](#)

---

#### ...15 vjet më parë...

...miratohet [VKM Nr.684, dt.02.11.2005](#), Për shpalljen e zonës shqiptare të liqenit të Shkodrës "Rezervat natyror i menaxhuar". [Fletore Zyrtare Nr.91, dt.1 Dhjetor 2005](#).

---

Për të lexuar Ditari i Natyrës në vite...[Kliko këtu!!!](#)

Udhëzime për të kontribuar në [Ditarin e Natyrës](#)



---

*Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA  
Redaksia: Nihat Dragoti, Ilirjan Qirjazi, Vilma Kadiu, Ergi Petanaj*

---

*Copyright © 2020 INCA - All rights reserved  
Adr.Rruga "Islam Alla", Pallati IVEA, Kati I, 1001  
TIRANA - ALBANIA*